



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

## UDHËZIM PLOTËSUES

**Nr. 3, Datë 17 /01 /2014**

### **“PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2014”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 19 të ligjit nr. 185/2013 “Për Buxhetin e vitit 2014” dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, paragrafi 2, Ministri i Financave

### UDHËZON :

#### **I. Procedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit të Shtetit**

##### **Të Përgjithshme**

1. Për çdo njësi shpenzuese të krijuar rishtazi, çelet kodi përkatës në sistemin informatik financiar të qeverisë, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, e shoqëruar detyrimisht me aktin përkatës ligjor ose nënligjor apo akte të tjera administrative të krijimit të tij. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastin e mbylljes së një njësie shpenzuese.

##### **Detajimi i disa fondeve buxhetore**

2. Fondi i planifikuar për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, në artikullin 604, detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Në zbatim të VKM-së, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor paraqet tek nëpunësi i parë autorizues, struktura përgjegjëse për buxhetin, detajimin sipas strukturave buxhetore të miratuara. Fondet për spitalet bëhen të disponueshme në kapitullin 08 (burimi i fondit buxhetor).
3. Në buxhetin vjetor të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, janë planifikuar fondet për investime për arsimin universitar edhe në formën e fondeve për zhvillimin e

rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të cilat miratohen nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë mund të bashkëfinancojnë për objekte investimesh edhe nga të ardhurat e veta.

4. Zbatimi i vendimeve gjyqësore që lidhen me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe rikthimi i vlerave të arkëtuara, subjekteve që u është ndërprerë procesi i legalizimit në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 9482, datë 3.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin e integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, do të përballohen me të ardhurat e realizuara nga transferimi i parcelës ndërtimore, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë e kompensimit të pronave.
5. Investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve për infrastrukturën vendore çelen në strukturën Ministria e Linjës 00, Program xxxxx, Kapitull 05, të specifikuar me kode projekti. Shkresat e çeljes së këtyre fondeve do të hidhen në sistemin informatik financiar të qeverisë nga struktura përgjegjëse për thesarin në degë. Njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtën e ndryshimit të emërimit të projekteve.
6. Detajimi i fondeve për investime të miratuara në Ligjin e Buxhetit për vitin 2014, si dhe kërkesat për rishpërndarje apo për fonde shtesë për investime, do të paraqiten pranë nëpunësit të parë autorizues nga nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes qendrore, pasi të jetë marrë konfirmimi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Ministrinë dhe Institucionet Qendrore, në detajimin e planeve të miratuara të investimeve, do të mbajnë parasysh këto kritere:
  - Projektet e investimeve të propozuara për financim duhet të jenë pjesë e projekteve të propozuara dhe të shqyrtuara në Kuvend deri në datën e miratimit nga Kuvendi të ligjit të buxhetit për vitin 2014;
  - Financimi i projekteve në vazhdim nga viti 2013 ose me parë duhet të jetë pjesë e prioriteteve;
  - Financimi i detyrimeve lokale për TVSH-në, Taksa Doganore ose bashkëfinancimet nga buxheti i shteti për projektet me financim të huaj do të bëhet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të projekteve dhe në përputhje me vlerën e financimit të huaj të planifikuar;
  - Projektet e miratuara në kuadër të PBA 2014–2016, sipas prioriteteve sektoriale të propozuara nga Ministrinë dhe Institucionet Qendrore;
  - Projektet e reja të propozuara për financim në kuadër të buxhetit për vitin 2014 do të shoqërohen me formularët e projekteve dhe relacionin përkatës;
  - Projekte të reja të papërfshira në sa më sipër do të financohen vetëm në kushtet e emergjencës dhe të shoqëruar me një relacion të hollësishëm për domosdoshmërinë e investimit të kërkuar dhe pas miratimit paraprak nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes (MZHETS).

Nëse në listën e projekteve të detajuara nga Ministrinë dhe Institucionet Qendrore ka projekte të reja që nuk kanë qenë të përfshira në buxhetin vjetor të miratuar nga Kuvendi, MZHETS merr në konsideratë financimin e këtij projekti vetëm nëse është miratuar në kuadër të PBA 2014–2016 dhe nëse ka kaluar të gjitha fazat procedurale të parashikuara në udhëzimin “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i rishikuar. Projektet që plotësojnë kushtet e mësipërme, dhe me vlerë deri në 50 milionë lekë, do të financohen vetëm pas miratimit paraprak të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes. Projektet me vlerë mbi 50

milione lekë do të financohen vetëm pas shqyrtimit dhe miratimit në Komitetin Ndërmintor për Zhvillimin Ekonomik.

Nëse projekti i propozuar nuk ka qenë pjesë e PBA 2014–2016, dhe nëse nuk plotëson asnjë nga kushtet e mësipërme, kërkesa për financim do të bëhet vetëm në kuadër të rishikimit të buxhetit vjetor.

Nëse në listën e detajuar të projekteve të investimeve nga njësitë e qeverisjes qendrore, listohen projekte që paraqesin kontrata të punimeve shtesë, çelja e tyre do të bëhet nga Ministri i Financave, bazuar në relacionin mbi domosdoshmërinë e tyre dhe me miratim paraprak të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastin e rialokimeve të projekteve të investimeve gjatë zbatimit të buxhetit.

7. Fondet për projekte të reja të investimeve dhe blerjen e pajisjeve elektronike, të cilat nuk e kanë ndjekur ciklin e planifikimit të investimeve publike, dhe që lidhen me Teknologjinë e Informacionit, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Në rastet kur në marrëveshjen dypalëshe, të nënshkruar për zbatimin e projekteve me financim të huaj, është përcaktuar që disbursimi nga donatori/kreditori do të bëhet pasi të jetë kryer shpenzimi dhe pasi të jetë vlerësuar performanca e projektit, atëherë për kryerjen e shpenzimit, ministrinë/institucionet, në rast se nuk kanë parashikuar fondet përkatëse në planin e buxhetit vjetor, do të shqyrtojnë mundësinë e një rialokimi për të siguruar fondet e nevojshme.

Fondet e rimbursuara nga financuesi sipas projekteve përkatëse, do të regjistrohen në një zë të veçantë për t'u dalluar nga grantet dhe kreditë e tjera, me emërtimin "Rimbursim i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës".

8. Në mbështetje të nenit 10 të ligjit 185/2013 "Për Buxhetin e vitit 2014", detyrimet e prapambetura dhe fondi i kompensimeve shpërndahen sipas ministrive përkatëse, sipas rregullave, procedurave dhe kriterëve të vendosura me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Numri i punonjësve buxhetorë dhe shpenzimet e personelit**

9. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror detajohet nga ministrinë dhe institucionet qendrore në përputhje me emërtesën e institucionit dhe numrit përkatës të saj të përcaktuar në urdhrin e miratimit të strukturës së çdo institucioni varësie. Si rregull, ky numër i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1 shkurt 2014, ndërsa në muajin janar, për pagesat e punonjësve do të operohet me numrin e punonjësve të muajit dhjetor. Të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore depozitojnë deri në datën 17 shkurt, në Ministrinë e Financave, urdhrat e miratimit të strukturave për çdo institucion varësie.
10. Në zbatim të nenit 11 të ligjit Nr 185/2013 "Për Buxhetin e vitit 2014, për vitin 2014 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit. Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përllogaritur, sipas gradave të miratuara. Përfashtim bëjnë institucionet e reja të krijuara gjatë vitit buxhetor.
11. Efektet financiare të ndryshimit të strukturave të njësive të qeverisjes qendrore përllogariten dhe vlerësohen nga struktura përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e

Financave.

12. Pagesat e listës së pritjes do të bëhen me bordero të veçantë. Paga e personit në listëpritje do të kalojë në shpenzime, në llogarinë ekonomike “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” të emërtuar art. 606, ndërsa sigurimi shoqëror shëndetësor do të kalojë si shpenzime në llogarinë e emërtuar art. 601. Institucionet që nuk kanë të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, shpenzime në art. 606, do të kërkojnë transferimin e këtyre fondeve nga shpenzimet korrente të miratuara. Edhe pagesa që lidhet me shpërblimin e parashikuar në Kodin e Punës për largimin nga puna për shkak të ristrukturimit për punonjësit, do të kalojë si shpenzim në llogarinë ekonomike “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” të emërtuar art. 606.
13. Numri rezervë i punonjësve përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit dhe alokohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Procedurat e detajimit dhe të miratimit përcaktohen në të njëjtën mënyrë si për punonjësit organikë.
14. Punonjës me kontratë të përkohshme pune, mbi numrin organik të miratuar, krahas atyre të miratuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, konsiderohen edhe instruktorët e qendrave të formimit profesional të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe anketuesit e Institutit të Statistikave.
  - a. Për instruktorët e qendrave të formimit profesional, hartohet udhëzimi vjetor i përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe më pas bëhet autorizimi i pagesave për këta punonjës.
  - b. Për anketuesit e INSTAT, detajimi i punonjësve për çdo rreth, afati kohor, emërtesa dhe niveli i pagës bëhen nga vetë INSTAT-i, sipas udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 24.3.2010.
15. Çdo ndryshim i numrit të punonjësve nga një njësi shpenzuese tek tjetra, shoqërohet detyrimisht me aktin përkatës të strukturës së miratuar të njësisë shpenzuese. Përrjashtimisht nga ky rregull, veprohet:
  - a. Për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Gjykatave, për transferimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve nga një njësi shpenzuese në një tjetër, miratimi i ndryshimit të numrit të punonjësve organik, bëhet pas vlerësimit të kostos financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit të shoqëruar me urdhrin përkatës të emërimit të prokurorit/gjyqtarit.
  - b. Çdo transferim i numrit të punonjësve mësimore organik nga një shkollë në tjetrën, bëhet pas vlerësimit të kostos financiare nga struktura përgjegjëse për buxhetin dhe pas paraqitjes së kërkesës së institucionit qendror.
16. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret nga çdo njësi shpenzuese për numrin faktik mujor të punonjësve në organikë, brenda numrit limit të miratuar. Nuk lejohet përdorimi i fondit të lirë që rezulton nga strukturat e paplotësuara apo nga reduktimi i strukturave aktuale dhe vetëm në raste specifike, përdorimi i këtij fondi miratohet nga Ministria e Financave. Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore përdoret për pagesën e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, kur është parashikuar një fond i tillë nga Ministria e Financave.
17. Në zbatimin e fondit limit të pagave të mbahen në konsideratë rregullat e përcaktuara në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

18. Plotësimi i borderosë së pagave të bëhet sipas shtojcës nr. 4 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

### **Fondi i Veçantë**

19. Fondi i veçantë i njësive shpenzuese nuk është pjesë e fondit të pagave pasi ky fond do të alokohet dhe përdoret me miratim të Ministrit të Financave.
20. Limiti maksimal i fondit të veçantë, i parashikuar për t'u përdorur për çdo njësi të qeverisjes qendrore, është përcaktuar në tabelën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Njësitë e qeverisjes qendrore njoftojnë të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë për limitin maksimal të fondit të veçantë për t'u shpenzuar prej tyre. Përdorimi i fondit të veçantë bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e Fondit të veçantë" i ndryshuar.
21. Kërkesat për përdorimin e fondit të veçantë, brenda limitit të njoftuar do të paraqiten rast pas rasti nga njësitë e qeverisjes qendrore tek nëpunësi i parë autorizues, i cili i shqyrton nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin dhe propozon për miratim tek Ministri i Financave. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe informacionin lidhur me shumën e përdorur nga fondi i veçantë deri në momentin e paraqitjes së kësaj kërkesë.
22. Në fondin limit të përcaktuar sipas pikës 20, nuk përfshihet fondi i veçantë i njësive të qeverisjes vendore, i Fondeve të Sigurimeve Shoqërore, i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, i Universiteteve dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për Bashkitë dhe Komunat dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit për Bashkitë dhe Komunat. Për këto institucione, kërkesa për përdorim nga fondi i veçantë me destinacion të përcaktuar në shkresë, paraqitet nga njësia shpenzuese në Degën e Thesarit, duke respektuar kriteret e VKM-së nr. 929, datë 17.11.2010, i ndryshuar. Në rast të përdorimit ai transferohet nga vetë njësitë nga artikulli 600 në artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës së shpenzimit. Një kopje e kësaj kërkesë paraqitet nga Dega e Thesarit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit për t'u regjistruar në sistemin informatik financiar të qeverisë.

### **Kontrolle financiare paraprake shtesë në procesin e menaxhimit të fondeve publike**

23. Për qëllime të një menaxhimi financiar eficient të fondeve publike dhe parandalimit të krijimit të detyrimeve të papaguara në kohë, çdo njësi e qeverisjes qendrore depoziton regjistrin e prokurimeve publike zyrtarisht dhe elektronikisht në Degën e Thesarit në fillim të çdo viti buxhetor, si dhe çdo ndryshim të tij gjatë vitit, përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Në çdo rast, shuma totale e prokurimeve duhet të jetë e barabartë ose më e vogël se fondet e miratuara për vitin buxhetor.
24. Në rast se parashikohen prokurime për kontrata shumëvjeçare, ato duhet të paraqiten në regjistër, duke specifikuar veçmas fondin e nevojshëm për vitin buxhetor 2014 dhe fondet e parashikuara për secilin vit buxhetor, deri në plotësimin e shërbimeve/punimeve të planifikuara.
25. Dega e Thesarit kryen kontrollin e totalit të fondeve të paraqitura në regjistrin e prokurimeve me totalin e fondeve të miratuara në buxhetin e njësisë, dhe vetëm pasi vulozet nga Thesari, njësia mund ta dërgojë në Agjencinë e Prokurimeve Publike.

26. Institucionet buxhetore te cilat operojnë direkt ne SIFQ, regjistrojnë ne sistem çdo vlere prokurimi te përcaktuar ne planin e miratuar te prokurimeve te institucionit dhe pasi marrin numrin unik te regjistrimit ne SIFQ dhe vulën e thesarit, procedojnë me dërgimin ne Agjencinë e Prokurimeve Publike.
27. Të gjithë urdhrat e prokurimit që nxirren gjate vitit për mallrat, shërbimet dhe investimet duhet te paraqiten ne degën e thesarit se bashku me ftesën për prokurim të cilat duhet: (i) t'i përmbahen listës së prokurimeve të dorëzuar në thesar, (ii) të kontrollohen për përputhshmëri me regjistrin e prokurimeve dhe të vulosen nga dega e thesarit së rrethit, përpara procedimit, sipas rregullave të prokurimit publik.
28. Deri në përcaktimin e limiteve të angazhimeve trevjeçare, me vendim të Këshillit të Ministrave, do të procedohet vetëm me miratimin e urdhrave njëvjeçare të prokurimit.
29. Në zbatim të detyrimit sipas pikave të mësipërme, dega e thesarit krijon bazën e të dhënave jashtë SIFQ, duke regjistruar për çdo institucion, kundrejt buxhetit të miratuar, çdo projekt investimesh dhe çdo për prokurim mallrash dhe shërbimesh me vlerë mbi 30 milionë lekë, vlerën totale sipas planit të prokurimit dhe në rastin e prokurimeve shumëvjeçare regjistron edhe shpërndarjen e shumës së tyre në vite.
30. Dega e thesarit informon strukturën përgjegjëse te buxhetit në Ministrinë e Financave, një herë në muaj, brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës, mbi urdhrat e prokurimit të miratuara prej saj sipas pikës 29 te këtij udhëzimi dhe sipas strukturës buxhetore. Njëkohësisht dërgon informacion të detajuar tek Nëpunësi i Parë Autorizues për prokurimet e shërbimeve me vlerë 30 milionë lekë e lart dhe për investimet.
31. Nëse në degën e thesarit paraqitet një urdhër prokurimi i pambuluar me fonde buxhetore, atëherë dega e thesarit refuzon me shkrim dokumentin e paraqitur dhe për këtë njofton Agjencinë e Prokurimit Publik. Në asnjë rast, APP-ja nuk fillon procedurën zyrtare të prokurimit, pa pasur më parë një miratim të degës përkatëse të thesarit.
32. Kontratat e lidhura nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore duhet të paraqiten dhe të procedohen në degën e thesarit të rrethit sipas kërkesave të udhëzimit standard të zbatimit të buxhetit. Në rast vonese, dega e thesarit procedon me regjistrimin në SIFQ dhe njofton menjëherë Nëpunësin e Parë Autorizues, i cili ndërmer masa administrative ose inspektim financiar sipas kuadrit ligjor në fuqi. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për paraqitjen me vonesë në degën e Thesarit të dokumenteve që vërtetojnë shpenzimin e kryer.
33. Nëpunësi i Parë Autorizues, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për buxhetin, monitoron në mënyrë të veçantë ecurinë e përdorimit të fondeve buxhetore për vlerat e shërbimeve/punimeve shumëvjeçare.
34. Ministria e Financave do të zhvillojë një sondazh çdo tre muaj tek ministritë kryesore, nëse ka detyrime financiare të krijuara rishtas dhe të papaguara në kohë për të përcaktuar pagesat e reja të kërkueshme që rrjedhin nga faturat ose pretendimet e marra pas datës 1 janar 2014 dhe do të zhvillojë një analizë të periudhës së pretendimeve, duke përcaktuar përgjegjësinë dhe vendosur masa administrative sipas kuadrit ligjor në fuqi.

### **Menaxhimi i likuiditetit**

35. Njësia Qendrore e Përgjithshme paraqet urdhërshpenzimin, duke përcaktuar qartë data e pagesës së faturës sipas kontratës.

Në SIFQ regjistrohet data e faturës së furnitorit, data e urdhërshpenzimit të përgatitur dhe paraqitur në thesar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, data e regjistrimit të urdhërshpenzimit në SIFQ, si dhe data në të cilën duhet të kryhet pagesa për faturën respektive, e cila duhet të jetë në përputhje me kushtet e kontratës. Ky rregull zbatohet edhe nga institucionet buxhetore që kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ.

### **Transaksionet në valutë të huaj**

36. Gjatë procesit të menaxhimit të shpenzimeve të projekteve me financim të huaj, që administrohen me skemë të pjesshme thesari, transfertat nga llogaritë speciale në Bankën e Shqipërisë në llogaritë bankare të projekteve me financim të huaj, kryhen në monedhën shqiptare nga struktura qendrore përgjegjëse për thesarin, përveç kontratave të lidhura në valutë të huaj sipas paragrafit 145 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012.

### **Llogaritë speciale:**

#### **Llogaria speciale e të përndjekurve politikë:**

37. Nëpunësi autorizues i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë do të përdorë fondet e planifikuara për të përndjekurit politikë në grupin 25, në masën dhe sipas listëpagesave të miratuara nga NPA.
38. Në udhëzimin nr. 9, datë 11.4.2012 “Për procedurat e përlllogaritjeve dhe pagesave të dëmshpërblimeve për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist”, pika 14 dhe 15 bashkohen dhe ndryshojnë si më poshtë: struktura përgjegjëse në Ministrinë e Financave harton listëpagesën dhe mbi bazën e tyre përpilon përmbledhësen për çdo bankë. Përmbledhësja totale e pagesave e detajuar për çdo bankë të nivelit të dytë i dërgohet Nëpunësit Autorizues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për procedimin e pagesës në llogaritë e bankave të nivelit të dytë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse të thesarit në degë.
39. Në prioritetet e pagesave sipas pikës 139 të udhëzimit nr. 2, datë 6.02.2012, të konsiderohet prioritet “transaksioni i pagesës për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve”, në renditje direkt pas pagesës “ndihmë ekonomike”.
40. **Llogaria speciale e shpronësimeve:** Gjendja që ka mbetur në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në Bankën e Shqipërisë, do të përdoret me paraqitjen e listës së përfituesve në zbatim të VKM-ve përkatëse të angazhuara.

### **Të ardhurat jashtë limitit**

41. Në të ardhurat jashtë limitit, të cilat mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të hyrat e mëposhtme:
- Të hyrat që mblidhen nga Zyrat e Përmbarimit për llogari të të tretëve;
  - Të ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga llotosporti ose nga sponsorizimet e tjera;
  - Fondet e akorduara nga Kompania Energjetike Shqiptare për përballimin e dëmeve nga përmytjet;
  - Të ardhurat nga organizmat e vlerësimit të konformitetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit, që përdoren për pagesën e vlerësuesve të

- kontraktuar nga kjo drejtori në zbatim të ligjit nr. 9824, datë 01.11.2007 “Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, VKM -së nr. 1716, datë 03.10.2008 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit” dhe standardit S SH ISO 17011:2005 që rregullon veprimtarinë e organizmave akreditues;
- e. Të ardhurat e realizuara nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje “Për transferimin e parcelës ndërtimore”, sipas aktrakordimit midis zyrës qendrore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritit të Ndërtimeve Informale (Aluizni) dhe strukturave përgjegjëse për thesarin në degë, të cilat nuk janë transferuar në llogarinë speciale të fondit të kompensimit të pronave, pranë Bankës së Shqipërisë;
  - f. Të ardhurat nga Parku Kombëtar i Butrintit;
  - g. Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, Inspektoriatit Qendror Teknik, Institutit të Ndërtimit, Universitetit të Tiranës dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganore”.
  - h. Të ardhurat e realizuara nga shitja e mallrave rezervë shtetërore gjatë procesit të freskimit të mallrave rezervë dhe që përdoren për zëvendësimin e mallrave të shitura;
  - i. Të ardhurat gjendje prej 15 127 500 lekësh, të mbledhura nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, të vitit 2006, të cilat në bazë të VKM-së nr. 868, datë 27.10.2010, përdoren për shpenzimet që nevojiten për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondet kundërparti dhe “*Non Project Grand Aid*”;
  - j. Të ardhurat nga INSIG-u për pagesat që do të kryhen për rastet e dëmtimit të mjeteve të siguruara;
  - k. Të ardhurat e realizuara nga pagesat e kryera nga operatori ekonomik për mbulimin e shpenzimeve për punonjësit e rekrutuar në mbështetje të kontratës specifike të nënshkruar midis tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në zbatim të VKM-së nr. 143, datë 13.02.2013 «Për disa shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.04.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”»;
  - l. Të ardhurat e realizuara nga fondet e transferuara nga ana e partive politike për llogari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të cilat përdoren për kryerjen e pagesave të ekspertëve kontabël të licencuar në zbatim të ligjit nr. 10 374, datë 10.2.2011 “Për partitë politike”, të ndryshuar.
  - m. Të ardhurat e institucioneve, të realizuara nga fondet e akorduara nga Fondi i Posaçëm Për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimit ligjor”.
42. Në të ardhurat jashtë limitit që nuk mbarten në vitin buxhetor pasardhës, përveç përcaktimit në udhëzimin e procedurave standarde të zbatimit të buxhetit, përfshihen edhe të ardhurat e mëposhtme:
- a. Të ardhura nga shitja e dokumentacionit tatimor, pullave fiskale dhe biletave të transportit rrugor;
  - b. Të ardhurat nga shtëpitë e pushimit të Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shqiptar, si dhe të ardhurat nga shërbimi i transportit të mjeteve të bllokuara (karrotreci) dhe të ardhurat nga parkimi”;
  - c. Të ardhurat nga privatizimi që përdoren për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore nga Ministria e Financave që lidhen me procesin e privatizimit, si dhe të ardhurat që përdoren për likuidimin

- e shpenzimeve të kryera për këtë proces;
- d. Të ardhurat deri në 10 milionë lekë, që siguron çdo vit Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë nga shërbime metrologjie, në zbatim të VKM-së nr. 571, dt. 29.08.2012;
  - e. Të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e realizuara nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë;
  - f. Të ardhurat e gjykatave nga tarifa e shërbimeve që kryen administrata gjyqësore të përcaktuar në udhëzimin nr. 13, datë 12.2.2009.

## **II. Kritere dhe procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit vendor**

43. Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore (bashki/komunë dhe qarqe) çelet 35% në tremujorin e parë, 20% në tremujorin e dytë, 20% në tremujorin e tretë dhe 25% në tremujorin e katërt.

44. Për njësitë e qeverisjes vendore:

- a. Sipas aneksit 4 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive, Berat, Çorovodë, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Ersekë, Leskovik, Lezhë, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Pukë, Tiranë, Vlorë, Sarandë dhe të komunave Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe dhe Bushat Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të konvikteve të arsimit parauniversitar;
- b. Për njësitë e qeverisjes vendore sipas aneksit 5 të ligjit, në transfertën e pakushtëzuar të bashkive Berat, Elbasan, Kuçovë, Kukës dhe Shkodër, janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të shërbimit dhe shpenzimet operative për qendrat “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan dhe qendrat ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara për bashkinë Kuçovë, Kukës dhe Shkodër.

Mbi këtë bazë, çdo njësi e qeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në Këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga Këshilli depozitohet në Ministrinë e Financave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

45. Në vijim të përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” (pjesa e buxhetit vendor), jepen procedura plotësuese për vitin 2014 si më poshtë vijon:

- a. Për funksionet e deleguara: Shpenzimet për mbrojtjen sociale: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2014, detajon fondet e mbrojtjes sociale në mënyrë periodike, për çdo njësi të qeverisjes vendore, si dhe në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë. Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Fondet e mbrojtjes sociale delegohen si transfertë e kushtëzuar për çdo njësi të qeverisjes vendore. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në detajimin e fondeve të mbrojtjes sociale, në mënyrë periodike, do të vlerësojë nevojat

- e njësisve të qeverisjes vendore, duke mbajtur parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive, transparente dhe mbi bazë kriteresh të përcaktuara.
- b. Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë që shpërndahen në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e tyre bëhen publike për të gjitha bashkitë dhe komunat.
  - c. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë financo bashkitë për *funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të qendrave të përkujdeset shoqëror që u shërbejnë individëve, me qëllim sigurimin dhe ofrimin e standardeve. Financimi të bëhet me paraqitjen e projekteve dhe nivelin e financimit të bashkisë.*
46. Fondet për zhvillimin e rajoneve. Fondet për zhvillimin e rajoneve do të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe procedurave të parashikuara në aneksin nr. 3 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”.
  47. Të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësisve vendore. Kuota që njësitë e qeverisjes vendore derdhin në favor të Këshillit Qarkut, miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut, është e detyrueshme për t’u zbatuar në bazë të nenit 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Fondet e krijuara nga kuotat e anëtarësimit nuk duhet të përdoren për paga dhe shpërblime për personelin administrativ të Këshillit të Qarkut. Strukturat përgjegjëse për thesarin në degë, me autorizim të Këshillit të Qarkut, bllokojnë përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk zbatojnë vendimin e Këshillit të Qarkut përkatës.
  48. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë kufijtë e përcaktuar në këtë ligj për përdorimin e transfertës së pakushtëzuar, si kosto për personelin administrativ. Në shtojcën nr. 5 të këtij udhëzimi, janë klasifikuar njësitë e qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ. Në shpenzimet e personelit administrativ, përshihen pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e administratës të njësisë së qeverisjes vendore (komunës/bashkisë/qarkut), jo personelit që lidhet me kryerjen e shërbimeve publike.
  49. Të ardhurat nga renta minerare përdoren sipas kriterëve dhe procedurave që përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave. Renta e mbledhur në muajin dhjetor 2013, të cilën Drejtoritë Rajonale të Tatimeve/Doganave e raportojnë pranë Ministrisë së Financave, në vitin 2014, të llogaritet si rentë për vitin 2014, kurse renta që do të mblidhet në dhjetor 2014, të llogaritet si rentë për vitin 2015.
  50. Sipas nenit 15 të ligjit nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, kur shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për sistemin e pompimit rezultojnë debitore për furnizimin me energji elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes deri në fund të tremujorit të tretë, transferta e pakushtëzuar e njësisve të qeverisjes vendore e tremujorit të katërt bllokohet me urdhër të Ministrit të Financave. Njësitë e qeverisjes vendore njoftohen nëpërmjet degëve të thesarit për një bllokim të tillë dhe iu lihet një afat 5-ditor (një javë pune) për të rakorduar me sh.a. e ujësjellës-kanalizimeve dhe me kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike. Njësitë vendore që kontestojnë detyrimet e tyre, duhet ta vërtetojnë një gjë të tillë nëpërmjet rakordimit me kompaninë e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ta sjellin atë brenda afatit të cituar më lart. Pas 5 ditëve (një javë pune) të bllokimit të transfertës së pakushtëzuar të tremujorit

të katërt, Ministri i Financave me një urdhër të dytë, transferon transfertën e pakushtëzuar nga njësia vendore në sh.a. ujësjellës kanalizime me destinacion “Pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike” dhe për sistemin e pompimit e kushtëzon këtë transfertë për pagimin e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj kompanisë së shpërndarjes.

51. Në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore të vitit 2014, duhet të përfshihet edhe zëri i shpenzimeve për sh.a./ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve. Në këtë zë duhet të përfshihet pjesë që njësia vendore duhet t’i transferojë sh.a./ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve për mbulimin e kostos së furnizimit me ujë të pijshëm (kur kjo kosto nuk mbulohet nga tarifa).
52. Të gjitha njësitë e qeverisjes vendore të marrin masat e nevojshme për zbatimin e kërkesës ligjore, për njoftimin paraprak të detyrimit tatimor të miratuar me vendim të Këshillit Vendor, për të gjithë tatimpaguesit (ku përfshihen si tatimpaguesit familjarë, ashtu edhe bizneset), në territorin përkatës.

### **III.Përcaktime të fundit**

53. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë formatet e zbatimit të buxhetit bashkëlidhur si më poshtë:
  - a. Tabela 1 “Fondi i veçantë limit për vitin 2014”;
  - b. Shtojca 1 “Formati i detajimit të fondeve buxhetore”;
  - c. Shtojca 2 “Formati i transferimit të fondeve buxhetore”;
  - d. Shtojca 3 “Zbatimi i fondit limit të pagave”;
  - e. Shtojca 4 “Borderoja e pagave të njësive të qeverisjes së përgjithshme”;
  - f. Shtojca 5 “Klasifikimi i njësive të qeverisjes vendore, sipas numrit të popullsisë dhe kufirit përkatës të shpenzimeve të personelit administrativ”;
  - g. Shtojca 6 “Raportimi i financimeve të huaja”;
  - h. Shtojca 7 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve Buxhetore”
  - i. Shtojca 8 “Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve”;
  - j. Shtojca 9 “Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit”;
  - k. Shtojca 10 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Rezultateve”;
  - l. Shtojca 11 “Raporti i Projekteve me financim të brendshëm”;
  - m. Shtojca 12 “Raportimi i Fondit të pagave dhe Numrit të punonjësve të njësisë së qeverisjes vendore”;

- n. Shtojca 13 “Shkresa e njësive vendore për hapje llogari bankare huamarrjeje”;
  - o. Shtojca 14 “Formati i raportimit të aktiveve në pronësi” sipas paragrafit 258 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 6.02.2012.
54. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet e tij përfundojnë në 31 dhjetor 2014.

**SHKËLQIM CANI**

  
\_\_\_\_\_  
**MINISTËR**

